

**AKT THEMELIMI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
“Auto Quantum” SH.P.K.**

Ne Tirane, sot me date 23.02.2023 (dymije e njezete e tre), ne baze te ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” dhe Ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit” me vullnetin tone te lire dhe te plote vendosem themelimin e shoqerise “**Auto Quantum**” SH.P.K. me kushtet si me poshte vijon:

1, Genti Dizdari lindur me date 27.02.1997 ne Tirane, me banim ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, me karte identiteti Nr.J70227046D.

**NENI 1**

Ortaket themelues te shoqerise jane:

1, Genti Dizdari lindur me date 27.02.1997 ne Tirane, me banim ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, me karte identitetit Nr.J70227046D.

**NENI 2**

**Emertimi**

Emertimi i plote i shoqerise eshte Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar “**Auto Quantum**” SH.P.K.

**NENI 3**

**Selia**

Selia e perkohshme e Shoqerise “**Auto Quantum**” SH.P.K. do te jete ne Tirane, Rruga Musa Agolli, Pall CMA, Nr.22  
Pervec ushtrimit te aktivitetit ne nivel qendror, shoqeria ka te drejte te hap dege dhe zyra perfaqesimi brenda vendit ose jashte vendit. Selia e Shoqerise mund te ndryshoje me vendim te Asamblese se Pergjithshme.

**NENI 4**

**Kohezgjatja**

Kohezgjatja e shoqerise eshte me afat te pacaktuar, me perjashtim te rastit kur mbaron sipas parashikimeve te ligjit ose kur vendos Asambleja e Pergjithshme.

**NENI 5**  
**Objekti i veprimtarise**

Objekti kryesor i veprimtarise se shoqerise eshte si me poshte:

- ❖ Import- eksport dhe tregtim me shumicë dhe me pakicë i të gjitha llojeve të makinave si me poshtë motorrcikleta, motorë-varka dhe anije,autovetura, mikrobus, autobus, kamion transporti dhe makineri bujqësore etj.
- ❖ Import- eksport dhe tregtim me shumicë dhe me pakicë i pjesëve të këmbimit për të gjitha llojet e makinave si me poshtë, motorrcikleta, autovetura, mikrobus, autobus, kamion transporti dhe makineri bujqësore etj.
- ❖ Import-eksport dhe shitje me shumicë e pakicë të makinerive dhe pajisjeve për auto- servisa për të gjitha llojeve të makinave.
- ❖ Import-eksport dhe tregtim me shumicë dhe me pakicë i gjitha llojeve të gomave për makina si autovetura mikrobus, autobus, kamion transporti dhe makineri bujqësore, etj.
- ❖ Import, per te gjitha llojet e hidrokarbureve, si vajra, solucioni etj.
- ❖ Shërbime per auto-servise për makina, si shërbim xhenerik, shërbim elektro-auto, për riparimin dhe ndërrimi i pjesëve për të gjitha llojeve të makinave, jet private etj.
- ❖ Shërbimin e riparimit dhe të lyerjes të gjitha llojeve të makinave.
- ❖ Shërbim të gomisterisë për ndërrim dhe riparim të të gjitha llojeve të gomave për makina.
- ❖ Shërbim të pastrimit dhe të larjes të të gjitha llojeve të makinave.
- ❖ Transporte dhe spedicione në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar, për interesin e saj dhe për të tretë.
- ❖ Import - eksport sipas legjislacionit shqiptar.
- ❖ Çdo lloj veprimtarie tjetër e ligjshme sipas legjislacionit Shqiptar.

**NENI 6**  
**Kapitali Themeltar**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 10.000 Leke. Ky kapital ndahet ne 1 kuote.

Kapitali themeltar i shoqerise ndahet ne kuota te zoteruara prej ortakeve, si me poshte:

Emri	Perqindja %	Kuota (pjese)	Shuma e kapitalit
<b>Genti Dizdari</b>	100%	1	10.000

**NENI 7**

Administrator i vetem dhe i pare i shoqerise do te jete **Z. Genti Dizdari**

**NENI 8**

Drejtimi, organizimi dhe funksionimi i shoqerise rregullohet sipas dispozitave te legjislacionit shqiptar si dhe ne baze te Statutit dhe ketij Akti Themelimi.

**NENI 9**  
**Dispozita e fundit**

Ky akt eshte perpiluar ne 4 (kater) kopje ne gjuhen shqipe me vlere te njejte ligjore.

Ortaket pasi e lexuan dhe kuptuan permbajtjen e ketij Akti Themelimi, me vullnetin e tyre te lire dhe te plote nenshkruajne si me poshte

**ORTAKU THEMELUES**

**Genti Dizdari**

